

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6964
E mërkurë, 9 gusht 2023
Çmimi 0.40

Eurodeputeti nga Holanda: Shpresoj që BE-ja t'i heqë masat ndaj Kosovës në shtator | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ARMEND MEHAJ KA DHËNË DORËHEQJE NGA POZITA E MINISTRIT TË MBROJTJES, NË VEND TË TIJ ËSHTË EMËRUAR EJUP MAQEDONCI | FAQE 4-5

KURTIT PO I LARGOHEN MINISTRAT E DIASPORËS



Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë, duke e arsyetuar atë me "shkaqe familjare". Kryeministri Albin Kurti ka thënë se e ka pranuar dorëheqjen e tij dhe e ka falënderuar "për punën e pandërprerë, kontributin

mbresëlënës, bashkëpunimin e rregullt dhe angazhimin e tij shembullor nga dita e parë e marrjes së detyrës". Kurti në vend të Mehajt, i cili kishte ardhur nga Norvegjia për t'u bërë pjesë e Qeverisë së Kosovës, ka emëruar ministër të ri të mbrojtjes Ejup

Maqedoncin. Dorëheqja e Mehajt është komentuar në mënyra të ndryshme nga opozita dhe shoqëria civile. Para dhjetë muajve ka dhënë dorëheqje edhe Rifat Latifi nga pozita e ministrit të Shëndetësisë, i cili kishte ardhur nga ShBA-ja

AKTUALE




SHKENCËTARËT EVROPIANË: KORRIKU, MUAJI MË I NXEHTË NDONJËHERË | F. 2

PËR KATËR DITË NË KLINIKËN E KARDIOLOGJISË U TRAJTUAN 14 RASTE TË PACIENTËVE ME ÇRREGULLIME TË ZEMRËS | F. 3

FESTA E VJELJES SË RRUSHIT 'HARDH FEST' MBAHET MË 1, 2 DHE 3 SHTATOR | F. 6

EKONOMI



KURTI: 20 MILIONË EURO INVESTIME NË EFIÇIENCË TË SHITËPIVE TË BANIMIT E NDËRTESAVE SHUMËBANESORE | F. 8

RRITEN TË ARDHURAT NGA TAKSAT MJEDISORE | F. 8

SPORT



KOSOVA SËRISH NË GRUP ME ZVICRËN | F. 10

ÇITAKU: PROKURORIA ÆRGJENTISHT T'I FILLOJË HETIMET PËR AFERËN ANTISHTETËRORE TË NDËRMJETËSUESIT TË QEVERISË KURTI | FAQE 7



ATK-ja INKASON 78.9 MILIONË EURO MË SHUMË SE NË VITIN E KALUAR | FAQE 8



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+389 44 487 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shkencëtarët evropianë: Korriku, muaji më i nxehtë ndonjëherë

BRUKSEL, 8 GUSHT - Organizata evropiane që monitoron klimën e ka bërë zyrtare konstatimin: Korriku i vitit 2023 ishte muaji më i nxehtë në Tokë i regjistruar ndonjëherë.

Temperatura mesatare botërore në muajin korrik prej 16.95 gradë celsius, por këtë vit ishte një e treta e gradës më e lartë sesa rekordi paraprak i regjistruar më 2019, tha Shërbimi për Ndryshime Klimatike, një degë e programit hapësinor të Bashkimit Evropian. Thyerja e rekordeve të temperaturave globale zakonisht bëhet me të qindrat ose me të dhjetat e një grade, prandaj diferenca aktuale

është e pazakontë. "Këto rekorde kanë pasoja të rënda për njerëzit dhe planetin që po ekspozohen gjithnjë e më shpesh ndaj ngjarjeve ekstreme dhe intensive", tha drejtoresha e këtij shërbimi, Samantha Burgess.

Valë vdekjeprurëse të të nxehtëit kanë goditur jugperëndimin e Shteteve të Bashkuara, Meksikën, Evropën dhe Azinë. Disa studime kanë fajësuar ndryshimet klimatike të shkaktuara nga njeriu, sikurse djegia e qymyrit, përdorimi i naftës dhe i gazit natyror. Ditët gjatë korrikut ishin më të nxehtat që janë regjistruar ndonjëherë. Temperaturat ishin

aq të larta sa që Shërbimi i BE-së dhe Organizata Botërore e Meteorologjisë bënë një njoftim të mëhershëm se korriku pritej të ishte më i nxehti në histori, para se muaji të përfundonte. Njoftimi i 8 gushtit vetëm ka konfirmuar këto konstatime.

Korriku i këtij viti ishte 1.5 gradë celsius më i nxehtë se në kohët paraindustriale. Më 2015, shtetet e botës u pajtuan që të parandalonin ngrohjen afatgjatë që është 1.5 gradë më e nxehtë sesa në epokën paraindustriale. Korriku i këtij viti ishte 0.7 gradë celsius më i nxehtë sesa mesatarja e regjistruar në këtë muaj në periudhën 1991-2020,



tha Shërbimi i BE-së.

Oqeanet e botës, ndërkaq janë për gjysmë gradë më të nxehtë sesa në 30 vjetët paraprak dhe temperatura në Atlantikun e Veriut ishte 1.05 gradë më e

nxehtë sesa është mesatarisht.

Ndërkaq, Antarktiku këtë vit ka shënuar nivelin më të ulët të akullit, 15 për qind më pak se mesatarja që regjistron zakonisht në këtë periudhë të vitit.

Ukraina vazhdon kundëroffensivën në juglindje

KIEV, 8 GUSHT - Kundëroffensiva ukrainase ndaj forcave ruse ka vazhduar në juglindje të shtetit, tha Kievi më 8 gusht, përdorur shifrat e viktimave nga një sulm rus me raketa në qytetin Pokrovsk një ditë më parë është rritur në shtatë të vrarë dhe pothuajse 70 të plagosur. Trupat ukrainase kanë vazhduar të kryejnë sulme ndaj ushtrisë pushtuese ruse në drejtim të Berdijanskut dhe Melitopolit në provincën e Zaporizhjes, tha Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë ukrainase.

Në njoftimin e ushtrisë u tha se forcat ukrainase kanë kryer nëntë sulme ajrore një ditë më parë, duke shënjestruar zonat ku ushtria ruse "ka përqendruar personelin, armët dhe pajisjet ushtarake".

Trupat ukrainase kryesisht kanë qenë në defanzivë që kur



Rusia nisi pushtimin në shkurt të vitit 2022. Megjithatë, Kievi ka nisur kundëroffensivën e tij

gjatë kësaj vere. Forcat ruse kanë kryer shtatë sulme me raketa dhe 42 sulme ajrore

gjatë 24 orëve të fundit, tha Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë ukrainase.

Ndërkaq, Ministria e Brendshme e Ukrainës tha se numri i viktimave nga sulmi rus me raketa më 7 gusht në qytetin Pokrovsk në rajonin e Donjeckut është rritur në të paktën shtatë dhe 67 të plagosur, teksa puna për kërkim-shpëtim ka rinisur mëngjesin e së martës.

Sipas ministrisë, në mesin e të plagosurve janë 29 zyrtarë policorë, dy punëtorë të shpëtimin dhe dy fëmijë.

Një fotografi e postuar nga ministria në rrjetet sociale shfaq një bllok banesash të dëmtuar rëndë, me katin e sipërm të shkatërruar plotësisht.

Zyrtarët rajonalë thanë se dy raketa goditën Pokrovskin më 7 gusht, duke shkaktuar dëme në ndërtesa të banuara dhe administrative, një hotel dhe disa dyqane.

Kina regjistron rënien më të madhe në eksporte që nga viti 2020

PEKIN, 8 GUSHT - Muajin e kaluar Kina ka shënuar rënien më të madhe në eksporte për më shumë se tre vjet, sipas të dhënave zyrtare të publikuara më 8 gusht. Ky njoftim vjen në kohën kur ekonomia e dytë më e madhe në botë është goditur nga kërkesa e ngadalë globale dhe nga një ngadalësim vendor. Këto të dhëna ka të ngjarë të rrisin thirrjet për liderët që të bëjnë më shumë për të ringjallur rritjen ekonomike, pasi autoritetet javëve të fundit kanë vendosur disa masa stimuluese që përqendrohen te konsumatorët dhe te sektori i

trazuar i pronave.

Shitjet e produkteve kineze në tregjet e huaja ranë për 14.5 për qind në krahasim me vitin e kaluar, u tha në të dhënat e autoritetit doganor. Kjo është rënia e tretë radhazi e eksporteve kineze.

Rënia e eksporteve është më e madhe sesa pritej dhe më e rënda që prej rënies prej 17.2 për qind në janar-shkurt 2020, kur ekonomia u godit në javët e para të shpërthimit të pandemisë Covid-19.

Përveç një rritjeje të shkurtër në mars dhe prill, eksportet kanë qenë në rënie të vazhdueshme

që nga tetori. Kërcënimi nga recesioni në Shtetet e Bashkuara dhe Evropë, së bashku me inflacionin e lartë, kanë kontribuar në dobësimin e kërkesës ndërkombëtare për produktet kineze në muajt e fundit.

Eksportet kanë rënë për 12.4 për qind krahasuar me qershorin e vitit të kaluar.

Dërgesat për në Bashkimin Evropian në shtatë muajt e parë të vitit kanë qenë 288.9 miliardë dollarë, apo 2.6 për qind më të ulëta, u tha në njoftimin e autoritetit të doganave. Ndërkaq, importet janë tkurrur



për 12.4 për qind, për muajin e nëntë me radhë. "Shifrat e tregtisë së Kinës për muajin

qershor janë sërish zhgënjyese", tha Ken Cheung Kin Tai, analist në Bankën Mizuho.

Eurodeputeti nga Holanda: Shpresoj që BE-ja i heq masat ndaj Kosovës në shtator

PRISHTINË, 8 GUSHT - Në tri ditët e fundit të gushtit Bashkimi Evropian mban takime informale të ministrave të punëve të jashtme e atyre të mbrojtjes. Me këto aktivitete përfundon pushimi veror i institucioneve të BE-së.

Një eurodeputet nga Holanda po pret që qysh në shtator unioni që ka 27 vende anëtare të lëvizë drejt heqjes së masave ndëshkuese që i vendosi ndaj Kosovës në qershor.

Thijs Reuten konsideron se Brukseli veprimi gabim ndaj Prishtinës zyrtare, kur vendosi masa ndëshkuese si pasojë e mosdeeskalimit të situatës në veri. Ndërkohë si pasojë e ujdisë së 10 korrikut BE-Kosovë, tashmë deeskalimi ka nisur në terren. Në dy turne 50 % e policisë u tërhoq nga dhe rreth godinave komunale në tri komuna. "Bashkimi Evropian ka ndërmarrë qasje izoluese e jo të balancuar, në atë se çka ndodhi në fund të majit. Duke harruar krejt çka ndodhi para dhe pas kësaj, ne nuk pamë një reagim kaq të fortë kur tre policë u kidnapuan në territorin e Kosovës nga Serbia. Këta policë, edhe pse janë liruar, ende po ndiqen penalisht", tha Reuten për Klan Kosova.



Ligjvënësi holandez në Parlamentin Evropian (PE) është një nga nënshkruesit e letrës së politikanëve evropianë e amerikanë dërguar në qendrat

vendimmarrëse që kërkon veprime konkrete sidomos në dialogun Kosovë - Serbi. "Presim koordinim të qartë mes BE-së, ShBA-së, Britanisë së Madhe dhe

aleatët e tjerë në komunitetin ndërkombëtar, sepse ne duhet të vijmë te linja e qartë, kur vjen puna që të flasim për përgjegjësinë e presidentit

Vuçiq, në gjithë procesin. Dhe ta bëjmë të qartë se po kthehemi te dialogu i lehtësuar nga BE-ja, drejt normalizimit, sa më shpejt që është e mundur", shtoi ai.

Për katër ditë në Klinikën e Kardiologjisë u trajtuan 14 raste të pacientëve me çrregullime të zemrës



EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 GUSHT - Disa nga shërbimet të cilat më parë qytetarët detyroheshin t'i merrnin jashtë vendit, tashmë kanë filluar t'i marrin në QKUK si rezultat i përbushjes së objektivës së Ministrisë së Shëndetësisë për shtimin e shërbimeve të reja dhe shfrytëzimin e ekspertizës nga profesionistë që veprojnë në sistemet më të avancuara shëndetësore, kjo për qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët tanë.

Në Klinikën e Kardiologjisë, njësinë e elektrostimulimit dhe elektrofiziologjisë, brenda katër ditëve janë trajtuar 14 raste të pacientëve me çrregullime të ritmit kardiak. Metoda me ablacion me

radiofrekuencë është realizuar me sistem modern të navigacionit 3D, si një mënyrë më e sigurt dhe efikase në këto raste. MSh-ja ka njoftuar kjo është bërë e mundur falë punës së ekspertëve të elektrofiziologjisë të këtij shërbimi në bashkëpunim me ekspertët elektrofiziologë nga Bullgaria, prof. Vassil Traykov dhe kryemjeku dr. Valon Spahiu i cili vepron në Heilbronn, Gjermani. Elektrostimulimi është një teknikë e përdorur për t'i stimuluar muskujt duke përdorur impuls elektrik. Përdorimi i elektrostimulimit ndihmon në rritjen e forcës muskulore, përmirësimin e qarkullimit të gjakut dhe zvogëlimin e dhimbjeve muskulore, ndërsa elektrofiziologjia përfshin studimin e impulsit elektrik të qelizave të ndryshme, si muskujt, nervat, zemra, truri etj.

Kurti priti në takim lamtumirës shefin e zyrës diplomatike të Belgjikës në Kosovë

PRISHTINË, 8 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të martën në takim lamtumirës shefin e Zyrës Diplomate të Mbretërisë së Belgjikës në Kosovë, Julien Sassel. Ai e falënderoi diplomatit Sassel për

kontributin e tij aktiv dhe bashkëpunimin e ngushtë në forcimin dhe thellimin e marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Belgjikës dhe, në të njëjtën kohë, i uroi suksese në angazhimet e tij të radhës. Zyra Diplomate e

Belgjikës së shpejti do të ngritet në nivel të Ambasadës së Belgjikës në Kosovë, duke dëshmuar kështu marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet dy vendeve dhe vullnetin reciprok për avancim të mëtejshëm të tyre.





ARMEND MEHAJ KA DHËNË DORËHEQJE NGA POZITA E MINISTRIT TË MBROJTJES,
NË VEND TË TIJ ËSHITË EMËRUAR EJUP MAQEDONCI

Kurtit po i largohen ministrat e diasporës

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë, duke e arsyetuar atë me “shkaqe familjare”. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se e ka pranuar dorëheqjen e tij dhe e ka falënderuar “për punën e pandërprerë, kontributin mbresëlënës, bashkëpunimin e rregullt dhe angazhimin e tij shembullor nga dita e parë e marrjes së detyrës”. Kurti në vend të Mehajt, i cili kishte ardhur nga Norvegjia për t’u bërë pjesë e Qeverisë së Kosovës, ka emëruar ministër të ri të mbrojtjes Ejup Maqedoncin. Dorëheqja e Mehajt është komentuar në mënyra të ndryshme nga opozita dhe shoqëria civile. Para dhjetë muajve ka dhënë dorëheqje edhe Rifat Latifi nga pozita e ministrit të Shëndetësisë, i cili kishte ardhur nga ShBA-ja

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 8 GUSHT - Kryeministri Albin Kurti ka njoftuar të martën se me kërkesë të ministrit të Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pranuar dorëheqjen e këtij të fundit dhe në vend të tij ka emëruar Ejup Maqedoncin. “Kërkesa për lirim nga detyra vjen për shkaqe familjare. Ministrin Mehaj e falënderova për punën e pandërprerë, kontributin mbresëlënës, bashkëpunimin e rregullt dhe angazhimin e tij shembullor nga dita e parë e marrjes së detyrës. Ministër të ri të Mbrojtjes emërova Ejup Maqedoncin, me të cilin kemi bashkëpunuar deri më tani në funksione të tjera. Ministrin Maqedonci i uroj punë të mbarë për avancimin e mbrojtjes dhe sigurisë, për zhvillimin dhe ndërtimin e ushtrisë sonë”, ka njoftuar Kurti.

Armend Mehaj kishte ardhur nga Norvegjia për t’u bërë pjesë e Qeverisë së Kosovës, të udhëhequr nga Albin Kurti, e cila u votua në mars të vitit 2021. Për dorëheqjen e tij ka njoftuar vetë Mehaj. “Sot, më 08 gusht 2023, në mirëkuptim dhe mirëbesim të plotë, me kërkesën time, kryeministri Albin Kurti më ka liruar nga detyra e ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kosovës! Kjo kërkesë prej anës sime ka ardhur për arsye familjare, për të cilat e kam njoftuar kryeministrin Kurti me kohë që më parë. Ai më falënderoi për punën time si dhe për të gjitha angazhimet e përbashkëta deri më sot, gjatë këtyre 29 muajve sa isha në detyrën e ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kosovës”, ka thënë Mehaj. Ai ka theksuar se pas shumë vitesh shërbim në uniformë, për të si ushtarak ka qenë përgjegjës

dhe privilegj ta merrte këtë detyrë kaq të lartë, nëpërmjet së cilës profesionalizmi dhe përvoja e tij ushtarake erdhën në shprehje në formë politikash dhe strategjish shtetërore. “Që nga 22 marsi i vitit 2021, kur u zgjodh qeveria Kurti 2 dhe deri sot, ka qenë një rrugë e gjatë dhe me plot sfida, me shumë punë dhe përpjekje, me përgjegjësi të lartë përballë detyrave dhe me vetëdije politike përballë historisë. Por në këtë rrugëtim kishim një vizion të përbashkët politik me kryeministrin Albin Kurti dhe me ministrat e Qeverisë së Kosovës, të cilët dua t’i falënderoj për punët e bëra bashkë deri sot si drejtues ministrish në kabinetin qeveritar. Në këtë pikë dua ta falënderoj veçanërisht kryeministrin e Republikës së Kosovës, Albin Kurti, për besimin e plotë dhe mbështetjen e vazhdueshme që

më ka dhënë nga dita e parë e deri sot”, është shprehur Mehaj. Ai ka folur edhe për pasardhësin e tij. “Jam i sigurt që kryeministri Kurti duke e emëruar Ejup Maqedoncin në detyrën e ministrit të Mbrojtjes e ka zgjedhur njeriun e duhur për këtë detyrë: një person profesionist, patriot dhe i dëshmuar”, ka thënë Mehaj. Në vazhdim ai ka folur për punën që ka bërë si ministër për më shumë se dy vjet. “Rruga që e kam ndjekur duke e drejtuar Ministrinë e Mbrojtjes është e dëshmuar dhe e evidentueshme, bashkë me të gjitha të arriturat, sukseset dhe përparimet që e kanë shoqëruar këtë institucion. Kam pasur fatin që të vihem në krye të Ministrisë së Mbrojtjes në një kohë kur Forca e Sigurisë së Kosovës është duke kaluar nëpër një fazë të transformimit sipas Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit. Për ushtrinë tonë, kjo është një periudhë shumë e rëndësishme historike, gjatë së cilës FSK-ja do t’i ngritë kapacitetet ushtarake në nivele të plota për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit të Republikës së Kosovës”, ka thënë ai. Mehaj ka thënë se brenda dy viteve të para të qeverisjes është dyfishuar buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, nga 64 milionë euro në 123 milionë euro, ndërsa janë rekrutuar edhe 1 836 ushtarë të rinj. “Më 2021 e kemi realizuar 96 për qind të buxhetit vjetor, kurse

më 2022 ky realizim ishte 95 për qind. Kurse këtë vit, deri më tani, kemi realizuar 57 për qind të buxhetit vjetor. I kemi shtuar trajnimet dhe shkollimet e ushtarëve dhe oficerëve për mbi 16 herë, duke i dërguar nëpër akademi ushtarake në ShBA, Mbretëri të Bashkuar, Gjermani, Turqi, Shqipëri, Kroaci etj. Kështu, përveç shtimit numerik të pjesëtarëve, tani Forca ka më shumë dije dhe profesionalizëm si dhe personel të trajnuar në përputhje me doktrinën e Forcës dhe sipas standardeve të NATO-s”, ka theksuar Mehaj. Ai ka folur edhe për blerjen e armatimit gjatë kohës sa ishte ministër. “Kemi bërë miliona euro blerje të armatimit dhe pajisjeve, për herë të parë përmes marrëveshjes të drejtpërdrejta ndërshtetërore, duke i shmangur dhe parandaluar keqpërdorimet e mundshme. Kemi arritur që për më pak se tri vjet ta pajisim Forcën e Sigurisë së Kosovës me sisteme të reja të armatimit, duke përfshirë sisteme të mbështetjes me zjarr dhe sisteme të mbështetjes ajrore. E kemi përfshirë Kosovën si vend pritës përveçse pjesëmarrës, në ushtrimet e mëdha ndërkombëtare ‘Defender Europe 2021’ dhe ‘Defender Europe 2023’, pas të cilave Forca e Sigurisë së Kosovës ka validuar njësi këmbësorie deri në nivel regjimenti. Për herë të parë në historinë e FSK-së, ushtarët tanë

Bërnabiqi e vlerëson si mbështetje për Kurtin letrën e ligjvënësve evropianë e amerikanë

BEOGRAD, 8 GUSHT - Kryeministria e Serbisë, Ana Bërnabiq, më 8 gusht shkroi në X se letra e ligjvënësve evropianë dhe amerikanë, përmes së cilës ata kërkuar qasje më të ashpër ndaj Serbisë, është “e mirëpritur” pasi, sipas saj, kjo është “provë e gjallë” që homologu i saj nga Kosova, Albin Kurti, në të vërtetë gëzon “mbështetje dhe inkurajim të plotë për cenimin e paqes dhe stabilitetit në Ballkan”.

Më 7 gusht dhjetëra politikanë nga Evropa dhe Shtetet e Bashkuara i dërguan një letër shefit të diplomacisë të bllokut evropian, Josep Borrell, kryediplomatit amerikan Antony Blinken dhe atij britanik James Cleverly. Përmes kësaj letrë ata kërkuar ndryshim të qasjes ndaj Kosovës dhe Serbisë.

Deputetja britanike Alicia Kearns, që publikoi letrën, tha se atë e kanë nënshkruar dhjetë kryetarë të komiteteve për punë të jashtme dhe 56 deputetë. Në mesin e nënshkruesve të kësaj letrë janë edhe senatori amerikan Bob Menendez dhe kongresisti Ritchie Torres.

Kjo letër u mirëprit nga

presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, që tha se ekspozon “agjendën shkatërruese dhe destabilizuese të Serbisë”.

Në letër u tha se “Kosova është përballur me pasoja të mëdha pas përpjekjeve të kryetarëve që të hyjnë në zyrat e tyre në veri të Kosovës”. “Kosova duhet të koordinohet me KFOR-in në të ardhmen për t'i parandaluar përshkallëzimet, por mungesa e presionit ndaj Serbisë pas ndalimit arbitrar të tre policëve të Kosovës dhe dështimi për t'i mbajtur përgjegjës ata që kryen sulme ndaj KFOR-it vënë në pah mungesën e barazisë në adresimin e tensioneve”, u tha në letër.

Në kohën e tensioneve në rritje, tre policë të Kosovës u arrestuan nga forcat serbe më 14 qershor. Kosova tha se ata u “rrëmbyen” brenda territorit të saj, por Serbia tha se i arrestoi “thellë brenda” territorit serb. Policët u liruan më 26 qershor.

Bërnabiqi shkroi në rrjetin X se shembulli më mbresëlënës i mungesës së besueshmërisë dhe objektivitetit të iniciuesve të letrës është se Alicia Kearns, “arriti të bëjë një prej njerëzve të paktë, deklaratat publike të së cilës u mohuan nga KFOR-i”. Bërnabiqi iu referua një



deklarate që Kearns bëri më 4 korrik, kur tha se armët nga Serbia në Kosovë po kontrabandoheshin përmes autoambulancave dhe se ato po “ruhen” në ndërtesat e Kishës Ortodokse Serbe. Më 5 korrik misioni paqeruajtës i NATO-s në

Kosovë, KFOR, deklaroi se rasti të cilit i është referuar deputetja britanike daton në vitin 2022, kur një batalion i këmbësorisë së Britanisë u përfshi në veri të Kosovës për ta mbështetur KFOR-in. “Prania e supozuar e armëve ilegale është raportuar në Shtabin e

KFOR-it, por pas hetimeve të mëtejme nuk janë gjetur prova” për kontrabandë, deklaroi KFOR-i.

Po atë ditë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, deklaroi se po punohej për verifikimin e informacioneve të paraqitura nga deputetja britanike. /Rel



kanë qenë pjesë e misioneve të mbështetjes së paqes në Lindje të Mesme dhe në Ishujt Falkland, përkrah ushtrive partnere të ShBA-së dhe Britanisë së Madhe”, është shprehur Mehaj.

Sipas tij, gjatë kësaj periudhe kohore është zbatuar suksesshëm dhe për periudha të gjata kohore misioni në mbështetje të autoriteteve civile gjatë pandemisë së virusit Covid-19 dhe operacionit për strehimin e refugjatëve afganë në Kosovë. “Profesionalizmi ynë u dëshmuar maksimalisht edhe gjatë operacionit të kërkim-shpëtimit, në ndihmë popullit turk, pas tërmetit të 6 shkurtit 2023. I kemi shtuar kontaktet dhe i kemi fuqizuar raportet e dyanshme me partnerët dhe aleatët tanë si Shtetet e Bashkuara të Amerikës,

Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Turqinë, Italinë, Shqipërinë, Kroacinë dhe me vende të tjera të NATO-s, ku Kosova synon të anëtarësohet si shteti i 33-të anëtar. Kemi nisur edhe shumë e shumë projekte dhe programe, që ndër vite do t'i prodhojnë efektet e tyre progresiste për forcimin e FSK-së, për çka i kemi angazhuar të gjitha burimet njerëzore dhe materiale në dispozicion, duke i menaxhuar në mënyra sa më efikase me qëllim të maksimalizimit të efektshmërisë”, ka deklaruar Mehaj, duke shtuar se gjatë gjithë kësaj kohe, puna e tij është drejtuar nga idealet kombëtare të dëshmorëve të lirisë. “Jam mbështetur në profesionalizmin dhe përvojën time ushtarake si dhe jam përpjekur që të drejtoj me përgjegjësi dhe integritet.

Është nder dhe privilegj krejt i veçantë të drejtosh një institucion si Ministria e Mbrojtjes, e cila bën politika për një ushtri që e ka origjinën nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. U jam mirënjohës dhe i falënderoj prindërit e mi, që më kanë edukuar në frymën e dashurisë për Kosovën dhe kombin shqiptar, siç e falënderoj bashkëshorten time dhe tri vajzat e mia për sakrificat e bëra gjatë kësaj kohe”, ka thënë Mehaj. Ai në fund të adresimit të tij përmes rrjeteve sociale ka theksuar se Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Republikën e Kosovës e presin edhe shumë punë dhe procese, në një rrugë të gjatë drejt forcimit të shtetit dhe garantimit të sigurisë së plotë të tij. Para dhjetë muajve ka dhënë dorëheqje edhe Rifat Latifi nga

Kush është ministri i ri i Mbrojtjes?

Ejup Maqedonci doli në pension të parakohshëm nga Forca e Sigurisë së Kosovës në korrik të këtij viti. Ai ka qenë pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Llapit. Më pas si pjesë e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) ka shërbyer për një dekadë si komandant i batalionit për kërkim-shpëtim.

Maqedonci më pas ka vazhduar detyrën e shefit të Departamentit të Operacioneve dhe Trajnimeve në Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së. Pas pensionimit, Mehaj i ka ndarë Maqedoncit “Medaljen e Karrierës” për kontributin e dhënë për formimin, ristrukturimin dhe modernizimin e FSK-së.

pozita e ministrit të Shëndetësisë, i cili kishte ardhur nga ShBA-ja për të marrë këtë post.

Opozita dhe shoqëria civile për dorëheqjen e Mehajt

Duke e komentuar dorëheqjen e Mehajt, deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Blerta Deliu, ka theksuar se “truri” po ik prej Albin Kurtit. “Largimi i Rifat Latifit dhe Armend Mehajt, dy ardhje nga jashtë vendit, janë dëshmi se përbrenda kësaj qeverie, jo vetëm qeverisja, por edhe mentaliteti është i kalbur. Përndryshe, para Armendit, është dashur të shkarkohen e jo t'u lejohej dorëheqja, Rozeta Hajdari, Mimoza Kusari - Lila, Martin Berishaj dhe nja 50

zyrtarë të tjerë të përfshirë në afera korruptive e skandale të ndryshme”, ka shkruar Deliu në “Facebook”.

Edhe drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka reaguar pas dorëheqjes së ministrit të Mbrojtjes, Armend Mehaj. “Kur qeveria nuk është vendore dhe përbëhet nga turistë sezonalë? Ata siç erdhën dhe shkuan për ta vazhduar jetën e tyre të shkëputur nga problemet tona e me një eksperiencë individuale më shumë. Sot askush nuk di se ku është ish-ministri i Shëndetësisë, sikurse s'do di askush ku do të jetë ministri, nga sot ish-ministri i Mbrojtjes, e nesër e pasnesër ministria e Punëve të Jashtme. Eksperiencë e mirë për jetën e tyre e asgjë domethënëse për Kosovën e qytetarët e saj”, ka shkruar Kryeziu në “Facebook”.

Komuna e Prizrenit vazhdon aksionin për hapjen dhe rregullimin e rrugëve fushore

PRIZREN, 8 GUSHT - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se po vazhdon aksioni i Drejtorisë së Bujqësisë

dhe Zhvillimit Rural për hapjen dhe rregullimin e rrugëve fushore në fshatin Novakë (1.000m).

“Rregullimi dhe mirëmbajtja e këtyre rrugëve është shumë me rëndësi për fermerët, pasi

u krijon qasje të shpejtë e të lehtë në pronat e tyre”, ka njoftuar komuna e Prizrenit.



Festa e vjeljes së rrushit ‘Hardh Fest’ mbahet më 1, 2 dhe 3 shtator

RAHOVEC, 8 GUSHT - Festa e Vjeljes së Rrushit, e njohur tashmë si ‘Hardh Fest’, do të mbahet më 1, 2 dhe 3 shtator në Rahovec. “Me të drejtë është festë për të gjithë ne. Festë e merituar për bujqit e vyeshëm dhe punëtorë të komunës së Rahovecit. Ky organizim ndër vite e ka identifikuar rajonin tonë vreshtar dhe e ka shndërruar në festë kombëtare të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe përtej saj. Si kryetar

i komunës së Rahovecit, ftoj të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të mos e humbasin rastin, të vijnë dhe të përjetojnë Festën e Vjeljes së Rrushit, Hardh Fest 2023!”, ka thënë kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi. Ai ka shtuar se gjatë këtyre tri ditëve dhe netëve organizatorët do të përkujdesen të ketë laramani të aktiviteteve kulturore, rekreative dhe turistike, që do të kulmojnë me koncerte në orët e mbrëmjes.



10 të rinj fillojnë punën praktike me pagesë në drejtorinë komunale të Kamenicës



KAMENICË, 8 GUSHT - Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporës, Burbuqe Leka, ka mbajtur takim me të rinjtë e përzgjedhur, të cilët do të zhvillojnë punë praktike me kompensim në institucionet komunale, me periudhë tremujore. Gjatë këtij takimi drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik dhe

Diasporës u uroi suksese dhe mbarësi praktikantëve të rinj, ku theksoi se së bashku me kryetarin Kadri Rahimaj po angazhohen maksimalisht që të jenë sa më afër të rinjve. “Me qëllim të promovimit të shkathtësive të punësimit, nxitjes së bashkëpunimit dhe fuqizimit të të rinjve në tregun e punës, K-GenU është

platforma përmes së cilës do t'i ndihmojmë të rinjtë për përmirësimin e tranzicionit nga shkolla në punë dhe për ta marrë përvojën e tyre të parë të punës”, është shprehur ajo. Ky program është partneritet në mes të Ministrisë së Financave, Unicef Kosovo Programme dhe Kosovo CSR Network.

Bulliqi nënshkruan memorandum për ndërtimin e fushës së tenisit në “Parkun Manchester”

PODUJEVË, 8 GUSHT - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtëm Bulliqi, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Pajtim Balaj, kanë zhvilluar takim me përfaqësuesen e Manchester Aid to Kosovo, Pamela Dawes, ku me këtë rast është bërë edhe nënshkrimi i memorandum bashkëpunimit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e fushës së tenisit në parkun Manchester. Vlera e këtij projekti parashihet të jetë 30 000euro. Komuna e Podujevës ka marrë

përsipër rregullimin e rrethojave dhe ndriçimin e hapësirave, ndërsa organizata Manchester Aid to Kosovo financimin e ndërtimit të fushës. Kryetari Bulliqi ka falënderuar Daees për kontributin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm të MAK-ut në Podujevë me organizatat, klubet lokale dhe afërsinë me qytetarët e Llapit, si dhe është zotuar për bashkëpunimin për realizimin e projekteve të tjera në dobi të të rinjve dhe sportistëve llapjanë.



Barnatorja e QKMF-së në Gjilan për herë të parë nis punën në dy ndërrime

GJILAN, 8 GUSHT - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka bërë me dije se për herë të parë në Gjilan,

barnatorja e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Nagip Rexhepi” nis punën me dy ndërrime nga

ora 07:00-20:00. Ai ka njoftuar se pas një kohe të gjatë rikthehet edhe shërbimi i vaksinimit me orar të zgjatur

të punës nga ora 07:00-20:00. “Ndryshimi rrënjësor në shëndetësi vazhdon”, është shprehur kryetari i Gjilanit.



Çitaku: Prokuroria urgjentisht t'i fillojë hetimet për aferën antishtetërore të ndërmjetësuesit të qeverisë Kurti



Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, në një konferencë për medie ka pyetur se kush e ka autorizuar Ridvan Muharremin për tregti ilegale të armëve, kush e ka autorizuar atë për prodhimin e dëshmitarëve të rrejshëm kundër krerëve të UÇK-së, kush ia ka kërkuar atij zhdukjen e një politikani të PDK-së dhe për cilin politikan bëhet fjalë, si dhe cili është roli i kryeministrit Kurti dhe i zyrtarëve të tjerë qeveritarë në të gjithë këtë aferë të paskrupullt

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 GUSHT (ER) - Pas raportimeve të medieve, që e përfshijnë ndërmjetësuesin e qeverisë Kurti për furnizim të rezervave shtetërore, Ridvan Muharremi, edhe me çështje të tjera si tregtia ilegale e armëve dhe krijimi i dëshmitarëve të paqenë kundër krerëve të UÇK-së, nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka kërkuar që

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, që urgjentisht t'i fillojë hetimet për ta zbardhur të vërtetën e këtyre pretendimeve. Çitaku në një konferencë për medie ka thënë se më 7 gusht, në dritën e zbulimit të fakteve të reja, edhe një herë qeveria Kurti është lidhur me keqpërdorime dhe situata të shumta, të cilat, këtë herë, nuk ishin vetëm materiale. "Reagimi i institucioneve të drejtësisë duhet të jetë emergjent. Të gjithë ju, të nderuar gazetarë e të

dashur qytetarë, dëgjuat dhe patë, me zë dhe figurë, dëshminë e një personi i cili ndërlidh ndërmjetësuesin e qeverisë Kurti për furnizim me rezervat shtetërore, Ridvan Muharremi, edhe me çështje të tjera. Tregtia ilegale e armëve, gjetja nga hiqi apo krijimi i dëshmitarëve të paqenë kundër krerëve të UÇK-së dhe zhdukja e një politikani të PDK-së, të gjithat ishin subjekt i kësaj dëshmie - e cila sot kërkon vetëm një gjë: hetim, hetim, hetim... Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës me urgjencë duhet të veprojë për ta zbardhur të vërtetën e këtyre pretendimeve, sepse ato nuk përfaqësojnë më vetëm korrupsionin enorm në të cilin është zhytur kjo qeveri, por edhe rrezikun që i kanoset lirisë, demokracisë e kombit tonë nga mentaliteti zhvatës e shkatërrimtar i kësaj qeverie", ka thënë ajo. Sipas Çitakut, këto deklarata dhe veprime të Ridvan Muharremit, mikut dhe bashkëpunëtorit të

kryeministrit Albin Kurti, paraqesin ndërhyrje të drejtpërdrejtë në drejtësi. "Mbi të gjitha, këto kërkesa specifike të Ridvan Muharremit për gjetjen e 'katër dëshmitarëve katolikë', ndikojnë në nxitjen e urrejtjes dhe përçarjes ndërfaqetare dhe popullore në vendin tonë. A ka qenë ndonjëherë në Mejë të Gjakovës Ridvan Muharremi, apo kushdo i cili e ka porositur që të bëjë kërkesa të tilla? Prandaj, meqë çështja është serioze, PDK-ja kërkon edhe veprime serioze, të përgjegjshme dhe të shpejta, të të gjitha institucioneve relevante të drejtësisë. Situata të tilla nuk guxojnë të kalojnë pa u hetuar, sqaruar e, më pas, padyshim, edhe pa u dënuar", ka thënë Çitaku. Çitaku ka pyetur se kush e ka autorizuar Ridvan Muharremin për tregti ilegale të armëve, kush e ka autorizuar atë për prodhimin e dëshmitarëve të rrejshëm kundër krerëve të UÇK-së, kush ia ka kërkuar atij zhdukjen e një politikani të PDK-së dhe për cilin politikan bëhet

fjalë, si dhe cili është roli i kryeministrit Kurti dhe i zyrtarëve të tjerë qeveritarë në të gjithë këtë aferë të paskrupullt. "Ndërkaq, kërkesat tona për Prokurorinë e shtetit janë të qarta. Niseni menjëherë dhe urgjentisht një hetim profesional mbi pretendimet e fundit të dëshmitarit në fjalë. Niseni menjëherë dhe urgjentisht hetimin e Ridvan Muharremit, përfaqësuesit të Qeverisë së Kosovës për furnizimin e rezervave shtetërore. PDK-ja kërkon që të hetohet edhe kryeministri Albin Kurti, emri i të cilit është ndërlidhur ngushtë me deklaratat e fundit, për çështje antishtetërore dhe antikombëtare. Sot nuk ka asnjë temë më të rëndësishme për gjithë sistemin e drejtësisë sesa hetimi urgjent i gjithë kësaj situatë. Qytetarët kanë nevojë për sqarime dhe llogaridhënie, nga të gjithë të përfshirët në këtë aferë të turpshme. PDK-ja kërkon hetim dhe përgjegjësi. Asgjë më shumë dhe asgjë më pak", ka thënë Çitaku.

Pa Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe Kosova mbetet e ndarë dhe përfundon shtet i dështuar

Prishtinë, 8 gusht - Njohësi i proceseve politike në vend, profesor Milazim Krasniqi, ka theksuar se pa Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe Kosova

mbetet e ndarë dhe përfundon shtet i dështuar. "Vetëm Asociacioni mund ta hapë procesin e vështirë të integritetit të serbëve.

Suksesi i integritetit të tyre nuk është i garantuar as me formimin e Asociacionit. Por në atë rast e garantuar është përkrahja e ShBA-së, BE-së

dhe NATO-s. Ajo përkrahje mbetet jetike për suksesin e Kosovës si shtet. Pa atë përkrahje Kosova as nuk mbijeton", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".



ATK-ja inkason 78.9 milionë euro më shumë se vitin e kaluar

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 GUSHT - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se ka inkasuar 78.9 milionë euro më shumë se në vitin e kaluar. "Në periudhën janar - korrik/2023 të hyrat e grumbulluara janë 514.8 milionë euro. Nëse i krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2022, kemi rritje mbi 78.9 milionë euro më shumë apo 18.1 %", ka njoftuar ATK-ja.

Administrata Tatimore e Kosovës ka theksuar se vazhdon punën në drejtim të rritjes së mbledhjes së të hyrave tatimore të cilat ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit. "Mjedisi në të cilin ATK vepron është kompleks dhe vazhdimisht pëson ndryshime, andaj kjo e detyron Administratën Tatimore të reagojë paanshëm në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi. Pikërisht në kuadër të kësaj, plani i të hyrave fokusohet në qëllimet strategjike si:

përmirësimi i mbledhjes së të hyrave dhe zvogëlimi i hendekut tatimor, pastaj forcimi i përmbushjes vullnetare në të gjitha segmentet e tatimpaguesve vazhdon të mbetet prioritet kryesor, duke u siguruar që tatimpaguesit paguajnë shumën e saktë tatimore dhe të ndërmerren veprimet e duhura ndaj tatimpaguesve mospërmbushës", është bërë me dije në njoftimin e ATK-së.

ATK-ja falënderon të gjithë tatimpaguesit të cilët i



kryejnë saktë dhe me kohë obligimet tatimore dhe i njofton tatimpaguesit jopërmbushës se do të

merren të gjitha veprimet ligjore për mospagesë të tatimit, siç parashihet me dispozita ligjore.


Kurti: 20 milionë euro investime në efijencë të shtëpive të banimit e ndërtesave shumëbanesore

PRISHTINË, 8 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka shkruar në "Facebook" për hapjen e thirrjes për masat e reja për rritjen e efijencës energjetike në shtëpitë private. "Për t'ua lehtësuar investimet në shtëpitë tuaja me qëllim që të keni dimra më të ngrohtë e vera më të freskëta, falë përkushtimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, mbështetjes së Bashkimit Evropian dhe

angazhimit të Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë nga sot kemi hapur thirrjen për masat e reja për rritjen e efijencës energjetike në shtëpitë private", ka thënë Kurti.

Ai ka theksuar se përmes këtyre masave të reja qytetarët do të mund të përfitojnë nga subvencionimi për termoizolim të mureve të jashtme dhe kulmeve dhe ndërrim të dritareve dhe dyerve të jashtme. "Subvencionimi do të mbulojë 45 për qind të vlerës së investimit,

deri në 5 500 euro. E për familjet ku shtëpia është bashkëpronësi e të dy bashkëshortëve apo në pronësi të gruas, subvencionimi arrin 50 për qind. Gjatë vitit të kaluar kemi subvencionuar 10 000 familje me 5 milionë euro për të blerë pajisje efijente për ngrohje. Këtë vit kemi trefishuar buxhetin për pajisje dhe me 20 milionë do të investojmë në efijencë të shtëpive të banimit e ndërtesave shumë-banesore të destinuar për banim social", ka thënë Kurti.



Integrimi energjetik, vendet e Ballkanit Perëndimor janë prapa me afatet



Tiranë, 8 gusht - Derisa vazhdojnë negociatat për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian, Komuniteti i Energjisë raporton se integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor sa i përket sektorit energjetik është duke mos arritur afatet e vendosura. Nëse deri në fund të 2023-s duhej të ishin miratuar legjislacionet përkatëse për t'u përshtatur me rregullat e BE-së, gjashtë

vendet nuk kanë dorëzuar ende draftet. Në 2025-n tregjet evropiane dhe ato të BP-së duhet të bashkohen për të avancuar në kapitujt energjetikë. Edhe në fushën e energjisë së rinovueshme, Shqipëria ka përshtatur vetëm një pjesë të kërkesave në ligjin për burimet e rinovueshme, ndërsa vendet e tjera ende nuk kanë marrë hapa konkretë. Ndërkohë, asnjë

vend nuk ka implementuar dokumentin e arritjes së zero emetimeve të karbonit deri në 2050-n, siç e ka BE-ja. Sa i përket ecurisë së vendeve në përpjekjet drejt tranzicionit të energjisë së rinovueshme, asnjë nga vendet nuk ka shtuar ndonjë impiant të ri energjie që punon me qymyr apo lëndë të tjera djegëse të dëmshme për mjedisin.

Rriten të ardhurat nga taksat mjedisore


PRISHTINË, 8 GUSHT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar për herë të parë statistikat e taksave mjedisore për vitet 2019-2021. Në vitin 2021 të ardhurat nga taksat mjedisore arritën në vlerën 330 974 696 milionë euro që, krahasuar me vitin 2020, ka pasur rritje prej 21.3-përqindësh. Në vitin 2021 të ardhurat nga taksat e energjisë-akciza kanë

pasur rritje për 22,2 për qind krahasuar me vitin 2020; të ardhurat nga taksat e ndotjes kanë pasur rritje për 64,4 për qind krahasuar me vitin 2020; dhe të ardhurat nga transporti kanë pasur rritje për 14,1 për qind krahasuar me vitin 2020.

Sipas strukturës së të ardhurave nga gjithsej taksat mjedisore për vitin 2021, taksat e energjisë zënë pjesën

më të madhe të të ardhurave me 289 318 140 milionë euro, ose 87,4 për qind, pasuar nga taksat e transportit me 39 828 802 milionë euro, ose 12 për qind, taksat e ndotjes me 1 827 754 milionë euro ose 0,6 për qind.

Në vitin 2021 përqindja e të ardhurave nga taksat mjedisore, e pjesëtuar me Bruto Produktin Vendor (BPV), ishte 4,16 për qind.



Egjiptianët e lashtë dhe bota e përtejme

Në Egjiptin e Lashtë, detyrë e rëndë ishte përgatitja e trupit të të vdekurve për jetën e përtejme, por a funksionojnë vërtet metodat e regjistruara në histori?



Nga: Cat Jarman
(arkeologe) / *The Daily
Telegraph*
Përkthimi: *Telegrafi.com*

Në shekullin XIX, mbreti i Persisë ia dërgoi një dhuratë mbretëreshës Viktorias – për shëndetin e saj. Dhurata në fjalë ishte një pako me mum, një substancë me fuqi të veçanta shëruese. Nuk e dimë nëse Viktoria e testoi, por ka gjasa që ajo dinte se mumi ishte pluhur i grirë i bërë nga mumiet njerëzore.

Kjo ide ka ekzistuar për një kohë të gjatë. Shkencëtari arab i shekullit XII, Abd el-Latif, ka shkruar se mumi nga mali i bitumit në Persi, mund

shëronte sëmundjet kur përzihet me ujë. Madje, edhe tekstet e shekullit të parë i lartësojnë virtytet e substancës. Fjala mumje rrjedh nga fjalët persiane dhe arabe që bëjnë me dije për dyllë (mum) dhe bitum (mumia), sepse arabët që takuan për herë të parë këta trupa të lashtë të ruajtur, menduan se ngjyra e tyre e errët vinte nga mbulimi i tyre me bitum.

Herodoti te Historitë e tij na tregoi se si në shekullin e pestë para Krishtit, egjiptianët i mumifikuan të vdekurit e tyre. Kishte opsione, shkroi ai, në varësi të buxhetit. Të pasurit shkonin për shërbimin premium: së pari, truri hiqej përmes hundës, me një grep.

Pastaj, organet u nxorën dhe zgavra e barkut u pastrua me verë palme dhe një ekstrakt të erëzave – para se të qepet përsëri. I gjithë trupi u vendos më pas në natron, për 70 ditë. Natroni, ose netri, kripa hyjnore, kishte efekt tharës dhe dehidruës. Më në fund, trupi u mbështjellë me lir. Gishtat dhe thonjtë e këmbëve lidheshin me fije për të qëndruar në vend dhe, më e rëndësishmja, organet gjinitale lidheshin me kofshën. Truri, për çudi, ishte ndër organet e pakta që nuk ruhej dhe që nuk mbahej në trup, pasi nuk konsiderohej si i rëndësishëm: zemra ishte vendi ku banonin shpirti, fryma dhe personaliteti. Para se të arrinin në jetën e lavdishme të

përtejme, zemra me një pendë do të peshohej nga Anubisi, nga perëndia me kokë çakalli. Nëse është shumë e rëndë, atëherë përjashtohet. Për shumë njerëz, trupi i mbuluar me qefin dekorohet për t'u dukur më i gjallë. Sytë mund të bëheshin prej liri ose, si në rastin e Ramzesit IV, të formuara nga dy qepë. Alternativë më e lirë kërkonte që të mos bëheshin prerjet në trup. Në vend të kësaj, vaji i kedrit u injektua përmes anusit, i cili më pas u mbyll për ta ndaluar daljen e lëngut. Më pas vinte kurimi i gjatë në natron, pas së cilës tapa u hoq dhe organet e brendshme të lëngshme dolën jashtë, duke lënë vetëm lëkurën dhe kockën.

Një ekip arkeologësh, duke e përdorur një lepur, eksperimentuan për të parë nëse kjo vërtet funksionoi. Krijesa e ngordhur u mbush deri në buzë me një klizmë të vajit bimor, u mbyll me kujdes dhe u la në rrjetë për 21 ditë (një reduktim në kohë duke pasur madhësinë e trupit). Kishte sukses: të gjitha organet ishin kthyer në lëngë, përveç zembrës.

Egjiptianët në fakt nuk ishin të fiksuar pas vdekjes, por më tepër pas jetës. Bota e përtejme ishte version edhe më i përsosur i së tashmes, ndaj pse të mos bëni gjithçka që është në fuqinë tuaj për ta siguruar një ekzistencë të lumtur?.

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT
 PILKINGTON
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Kosova sërish në grup me Zvicrën



PRISHTINË, 8 GUSHT - Është hedhur shorti për Rrethin e Parë Parakualifikues për Kupën e Botës 2027. "Dardanët" do të jenë sërish në grup me Zvicrën, ku së fundi e mposhtën dy herë. Në Prizren fituan 76:49, kurse në Fribourg triumfuan 72:76. Për herë të parë Kosova A do të përballet me Irlandën dhe Azerbajxhanin. Raundi i parë parakualifikues i Kupës së Botës të

Basketbollit FIBA 2027 do të luhet në tre dritare më 19-27 shkurt 2024, 18-26 nëntor 2024 dhe 17-25 shkurt 2025, nga një ndeshje në shtëpi dhe jashtë. Të tre fituesit e grupeve së bashku me skuadrën e renditur më të mirë në vendin e dytë do të kalojnë në raundin e dytë parakualifikues të Kupës së Botës 2027 të FIBA-s, i cili do të luhet në verën e vitit 2025.

Grupi A
 Zvicra
 Kosova
 Irlanda
 Azerbajxhani

SHKURT

Trajneri i Galatasarayt: Zgjedhja jonë e parë është Rashica

Milot Rashica vazhdon të jetë synimi kryesor i Galatasarayt në këtë afat kalimtar. Këtë lajm e ka e ka konfirmuar Bukar Okan, i cili e ka vlerësuar lart kontributin e Rashicës në edicionin e kaluar. "Milot Rashica është lojtari që bëri një punë të mirë në skuadrën tonë vitin e kaluar. Ne mund të themi se duam që ai të jetë në skuadër. Jemi në pritje. Duam ta shtojmë në skuadër një lojtar tjetër largpamës në krahë. Zgjedhja jonë e parë, natyrisht, është Rashica", ka deklaruar trajneri turk. Marrëveshja pritet të përfundojë për shumën 6-7 milionë euro.

Arbër Sinani i bashkohet Ponte Prizrenit

KB Ponte Prizreni ka njoftuar se ka nënshkruar me Arbër Sinanin, ka njoftuar klubi prizrenas në "Facebook". Sinani me Ponte Prizrenin ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me mundësi vazhdimi. "I dëshirojmë mirardhje lojtarit Sinani i cili vitin e kaluar me sukses mbrojti ngjyrat e skuadrës së Vëllaznimit. Në të kaluarën ishte pjesë e Sigal Prishtinës dhe Prishtinës së Re", thuhet në njoftim. Klubi prizrenas ka thënë se së shpejti do të paraqitet një lojtar i huaj.

KB Trepça përballë Parnu Sadam dhe Tindastoll



MITROVICË, 8 GUSHT - Është hedhur shorti për kualifikimet e FIBA Europe Cup. Fituesja e Kupës së Kosovës në basketboll, Trepça, do të ndeshet me skuadrën estoneze Parnu Sadam dhe atë islandeze Tindastoll. Kualifikueset do të zhvillohen në Parnu, Estoni. Vetëm vendi i parë do të kualifikohet në grupet e edicionit të rregullt në FIBA Europe Cup. Gjithsej janë shtatë grupe, një me katër

skuadra dhe gjashtë me tri. Kualifikimet do të zhvillohen më 2-5 tetor. Në edicionin e rregullt do të jenë 40 skuadra, të ndara në dhjetë grupe me nga katër skuadra. Trepça edicionin e kaluar ishte në kualifikimet e FIBA Europe Cup, madje organizatore e grupit në Mitrovicë, por që nuk kishte arritur kualifikimin në grupe. Nga Mitrovica ishte kualifikuar Sportingu. Edicionin e

kaluar Sigal Prishtina ishte në kualifikime, kurse Golden Eagle Ylli ishte pjesë e grupeve, ku nga gjashtë ndeshje kishte një fitore e pesë humbje.

Grupi C
 Parnu Sadam
 Tindastoll
 Trepça

Më 15 gusht shorti për kampionatin e ri në hendboll

Më 15 gusht do të tërhiqet shorti për kampionatin e ri të Kosovës në hendboll. Shorti për edicionin 2023/2024 në Superligën e meshkujve, Superligën e femrave dhe Ligën e kadetëve do të tërhiqet nga ora 15:00 në lokalet e Federatës së Hendbollit të Kosovës. Klubet kanë kohë deri më 11 gusht që të licencohen për garat e kampionatit të ri. Ndërkohë kontrollimi mjekësor i lojtarëve nis më 21 gusht.

Dukagjini ndan rrugët me futbollistin Rinor Kuçi

KF Dukagjini ka njoftuar se ka ndarë rrugët me marrëveshje të dyanshme me futbollistin Rinor Kuçi. Klubi nga Klina e ka falënderuar Kuçin për kontributin e dhënë në klub dhe i ka uruar suksese në vazhdim të karrierës. "Ju njoftojmë që me marrëveshje të dyanshme kemi mbyllur bashkëpunimin me futbollistin Rinor Kuçi. Ne e falënderojmë Rinorin për kohën sa ishte pjesë e Dukagjinit, duke i dëshiruar atij shumë suksese në sfidat e reja", thuhet në njoftimin e Dukagjinit.

Ramadani mahnit Italinë, futbollisti që duket si Gattuso dhe flet 6 gjuhë

LECCE, 8 GUSHT - Ylber Ramadani ishte transferimi i fundit i Lecces, me mesfushorin shqiptar që erdhi nga Aberdini për shumën e 1.5 milion eurove. Media e njohur italiane "TuttomercatoWEB" i ka kushtuar një artikull mesfushorit

të Kombëtares, i cili nis kështu një aventurë të re në Serinë A. Ai do të duhet të zërë vendin bosh të lënë nga Hjulmandi që pritet të transferohet te Sportingu i Lisbonës, me medien italiane që shkruan se ka një rol të rëndësishëm për Leccen këtë

sezon. Gjithashtu ajo shkruan: "Të gjithë që e kanë parë Ramadanin duke luajtur e krahasojnë atë me Rino Gattuson". "TuttomercatoWEB" ndalet edhe te jeta e Ramadanit. "Ai ka lindur në Starnberg të Gjermanisë, prindërit e tij janë

nga Kosova dhe është pjesë e kombëtares shqiptare", shkruan prestigjiozja. Gjithashtu, ajo është ndalur te fakti që Ramadani flet rrjedhshëm gjashtë gjuhë të huaja: shqip, gjermanisht, anglisht, danisht, hungarisht dhe italisht.



Linker: 'Epokës' së Lewandowskit po i vjen fundi

Fundjavën e ardhshme Primera Division do ta nisë sërish sezonin e ri. Lufta për kurorën e Spanjës fillon nga e para. Vitin e kaluar FC Barcelona festoi kampionatin me një epërsi të qartë ndaj rivalëve të tyre më të afërt - dhjetë pikë përpara Realit dhe njëmbëdhjetë pikë përpara Atletico. Sulmuesi i Barçës, Robert Lewandowski (34 vjeç), luajti një rol të madh në sezonin e tij debutues.

Polaku u transferua nga FC Bayern në Spanjë verën e kaluar dhe e çoi skuadrën e tij të re në titullin e parë që nga viti 2019 me 23 gola në 34 paraqitje.

Por kur bëhet fjalë për ekspertin e futbollit, Gary Lineker (62 vjeç), kohës së Robert Lewandowskit po i vjen fundi ngadalë. "Lewandowski ngadalë po arrin në fundin e epokës së tij. Ai ishte në vendin e nëntë te lista e futbollistëve më të mirë për disa vjet. Ishte Harry Kane një prej tyre në krye dhe sigurisht që tani është edhe Haaland. Nuk duhet të harrojmë as Cristiano Ronaldon, pasi ai u zhvendos më shumë në qendër nga e majta. Kylian Mbappe tenton të luajë në të majtë. Por nëse



më pyesni se cilin lojtar do të doja më shumë të kisha në ekipin tim, ai është Mbappe. Ai është paketa e plotë, e jashtëzakonshme!", ka thënë Linker për "SPORT BILD". Për vite me radhë polaku u konsiderua qendërsulmuesi më i mirë në botë në shërbim të FC Bayern. Ai theu dhe rekordin e sulmuesit gjerman Gerd Muller (40 gola në një sezon të Bundesligës) me 41 gola dhe fitoi të gjithë titujt në nivel klubesh me Bayernin që mund të fitoheshin. Ai ishte dy herë lojtari më i mirë i vitit

nga FIFA (2020, 2021), një herë Lojtari i Vitit në Evropë (2020) dhe dy herë ai ishte në gjendje ta fitonte Këpucën e Artë si golashënuesi më i suksesshëm evropian i një sezoni (2021, 2022). Për Barcelonën dhe Lewandowskin sezoni i ardhshëm nuk ka të bëjë vetëm me mbrojtjen e titullit të tyre në "La Liga", por edhe me përparimin sërish në Ligën e Kampionëve. Vitin e kaluar tashmë kishte përfunduar në fazën e grupeve dhe në Ligën e Evropës ata u eliminuan në raundin e dytë.

Derisa nuk dihet për shëndetin e Michael Schumacherit, vazhdojnë të shiten gjërat me të cilat ka shkruar histori

Hurth, 8 gusht - Makina ikonike e Michael Schumacherit që ka garuar në Formula 1 do të shitet për një çmim të majm në ankand. Legjenda e garave voziti Ferrarin F2001b kur fitoi Çmimin e Madh të Australisë në vitin 2002. Ferrari 3.0V10 në ngjyrë të kuqe po shitet nga RM Sotheby's, me një çmim fantastik mbi shtatë milionë euro. Një zëdhënës i RM Sotheby's ka thënë: "Ndër makinat më të dëshirueshme të çmimeve të mëdha të epokës moderne që ekzistojnë, shasia 215 luajti një rol të rëndësishëm në ditët e para të Kampionatit Botëror të Formula 1 në vitin 2002. Ecuria nga Michael Schumacher në sezonin e tij të pestë historik fitues të kampionatit, ai krenohet me një vend të parë në Çmimin e Madh



të Australisë 2002 dhe i treti në Çmimin e Madh të Malajzisë 2002, pasi u kualifikua në pole-position". "Pasi doli në xhiron e parë në Malajzi, Schumacheri u rikthye nga vendi i 21-të për të përfunduar i treti, një përpjekje

vërtet e jashtëzakonshme nga një pilot fantastik", ka shtuar ai. Një makinë e ngjashme e drejtuar nga Schumacheri në të njëjtin sezon u shit në vitin 2017 për 6.5 milionë euro. Ankandi zhvillohet nga data 16 deri më 19 gusht.

SHKURT

Një klub nga Arabia Saudite e kërkon Neymarin

Ylli i PSG-së, Neymar, vazhdon të jetë shumë i folur në këtë afat kalimtar. Raportohet se braziliani të hënën është takuar me drejtuesit e Paris Saint-Germainit, të cilëve ua ka komunikuar dëshirën për t'u larguar nga "Parku i Princave" gjatë kësaj vere. Besohet se ish-futbollisti i Santosit dëshiron të rikthehet në Barcelonë. Por, sipas portalit "footmercato.net", "O'Ney" një klub nga Arabia Saudite, ka hyrë në garë për transferimin e tij. Bëhet fjalë për një rrogë prej 300-400 milionë eurosh.

Iniesta firmos me klubin arab

Andres Iniesta është larguar pas pesë vjetësh nga Vissel Kobe e Japonisë dhe karrierën futbollistike do ta vazhdojë në kampionatin e Emirateve të Bashkuara Arabe, ku ka nënshkruar për Emirates Club. 39-vjeçari firmosi me klubin e tij të ri një kontratë njëvjeçare dhe klubi e njoftoi me shumë bujë nënshkrimin e spanjollit, i cili pritet të luajë futboll deri në 40-tat e tij, për të vendosur më pas nëse do të vazhdojë apo jo. Inisesa është një nga lojtarët më të mirë në historinë e Barcelonës.

Sommer nga Bayerni kalon në Inter

Yann Sommer është portieri i ri i skuadrës së Interit. Zvicerani ka nënshkruar kontratë trevjeçare, të vlefshme deri në qershor të vitit 2026. Reprerentuesi zviceran ishte gjithmonë objektivi i tyre i parë për t'i zëvendësuar Andre Onanën dhe Samir Handanoviçin, me të parin e shitur te Manchester Unitedi dhe të dytën të liruar nga kontrata. Negociatat me Bayernin u zvarritën për javë të tëra derisa Interi më në fund ra dakord të paguante 6 milionë euro të përcaktuara nga klauzola e liritimit, por ata arritën të merrnin një plan më të mirë pagese gjatë dy viteve. Ndërkohë, Interi ka ende nevojë për një portier të dytë dhe i është drejtuar Sampdoria për Auderon.

Kane u jep ultimatum Bayernit dhe Tottenhamit

"Telenovelës verore" të Harry Kanes tani i ka ardhur fundi, të paktën sipas "Daily Mail". Sipas asaj që raportohet nga ky medium, sulmuesi i Tottenhamit ka vendosur një afat për të ardhmen e tij, një datë përfundimtare, e cila skadon të dielën. Kane dëshiron të zgjidhë gjithçka deri në fund të javës, kur fillon Premierë Liga. Sulmuesi është i qartë me palët: ose Bayern Munchen do të gjejë një marrëveshje totale me Tottenhamin deri të dielën, ose edhe sezonin e ardhshëm kapiteni i Anglisë do të mbetet në Londër, me fanellën e "Spurs"-it.

Ramosi paraqitet te PSG-ja

Gonçalo Ramos ka firmosur me PSG-në. Sulmuesi portugez vjen nga Benfica dhe ka nënshkruar me kampionët e Francës në

formën e huazimit për një sezon. "Paris Saint-Germain njofton nënshkrimin e Gonçalo Ramosit. Sulmuesi portugez 22-

vjeçar bashkohet në formë huazimi me një opsion blerjeje deri në fund të sezonit", ka shkruar klubi. Ky afrim ka qenë

dëshirë e drejtpërdrejtë e trajnerit Luis Enrique. 22-vjeçari Ramos është aktivizuar në 30 ndeshje në Liga

Portugal në edicionin që kaloi, ku ka shënuar 19 gola. Futbollisti është produkt i akademisë së Benficës.



**BASIC COURT IN GJAKOVE
- BRANCH IN RAHOVEC**

Case number: 2023:115042
Date: 20.07.2023
Document number: 04508273

C. no. 409/2023

BASIC COURT IN GJAKOVE - BRANCH IN RAHOVEC, General Department, Civil Division, composed of single judge **Betim Behluli**, in the legal case of plaintiff Bujar Lushi from vill. Radoste Municipality of Rahovec - represented by the representative authorized lawyer Dardan Morina from Prizren, against the defendant Alba Hisen Morina from vill. Vrajak Municipality of Rahovec, with unknown address, due to the dissolution of the marriage dated **20.07.2023**, took this:

DECISION

The lawyer **Arta Himaj** from Rahovec, IS APPOINTED as temporary representative, for the defendant **Alba Hisen Morina** from vill. Vrajak Municipality of Rahovec, now with unknown address.

The temporary representative, in this contested legal matter, in the sense of article 82 of the LCP, has all the rights and duties of the legal representative which he undertakes for the defendant, now with an unknown address and that he has these rights and obligations, as a temporary representative, until the respondent herself or her representative by authorization appears in this court, respectively, until the guardianship body notifies the court about the appointment of the guardian.

This decision will be published in the Official Gazette of the Republic of Kosovo and in the Notice Board of the Basic Court in Prizren.

Reasoning

The plaintiff, Bujar Lushi from vill. Radoste Municipality of Rahovec, has filed the lawsuit against the defendant, Alba Hisen Morina from vill. Vrajak Municipality of Rahovec, with an unknown address, due to the dissolution of the marriage.

The court has sent to the plaintiff, Alba Hisen Morina, the decision to respond to the lawsuit dated 30.05.2023, but from the postal return slip it has been certified that the party lives in Germany and her family has refused to accept the mail. The court, by decision dated 11.07.2023, obliged the plaintiff to provide the address for the defendant.

Based on the request of the plaintiff's authorized representative, lawyer Dardan Morina dated 17.07.2023, in accordance with the decision dated 11.07.2023, requests the court to appoint a temporary representative for the defendant, since the correct address cannot be found her, while her only address is village Vrajak Municipality of Rahovec, and

Case number: 2023:115042
Date: 20.07.2023
Document number: 04508273

other address for the defendant cannot be provided for the court, also the defendant's family had to show her address in Germany, therefore, we propose to the court to appoint a temporary representative for the defendants.

Deciding, according to the proposal of the authorized representative of the plaintiff, the court found that the conditions of article 79.3 of the LPK, for the appointment of the temporary representative of the defendant.

From what was said above, it was decided as in the dispositive of this decision.

**BASIC COURT IN GJAKOVE - BRANCH IN RAHOVEC
C. no. 409/2023 dated from 20.07.2023**

The judge:
Betim Behluli - seal and signature

LEGAL ADVICE:

Right to appeal: Against this decision the dissatisfied party has right to appeal within 15 days, after receiving the same, to the Court of Appeal in Prishtina, through this court.

I, P. Avdullahu, translator of English language, hereby certify that the foregoing document in English language is a true and faithful translation of the original document in Albanian language submitted to me.

In Prizren, on 26.07.2023

Translated by:
P. Avdullahu, Court Translator



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Flemingo Kosovo" L.L.C. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810126278 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Flemingo Kosovo" L.L.C. Fushë Kosova, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810126278 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Flemingo Kosovo" L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, has come to the decision to quit its business: 810126278 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Florenza Hasi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Mentor Nreca nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e shkollës së mejkësisë "Hysni Zajmi".

- Dhurata Kycyku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e shkollës së mesme të Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Ardita Hazir Tahiri shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.

- Xheneta Ujkani shpall të pavlefshme diplomën e masterit drejtimi Ekonomiks në UP.

- Afrim Vehapi B.I. DPZ "ONIKS-1" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, për import-export, me numër unik të biznesit: 810345654.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

